

U D H Ë Z I M
Nr. 6278, datë 11.12.2000

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË BARRËVE SIGURUESE

Në bazë të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 26 të ligjit Nr.8537, datë 18.10.1999 “Për barrët sigurorese” Ministri i Financave

U D H Ë Z O N :

Neni 1
Përkufizimet

Termat e përdorura në këtë Rregullore kanë të njëjtim kuptim të dhënë nga ligji “Për barrët sigurorese”.

Automjet
është mjeti sipas përkufizimit të nenit 54 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë Nr.8378, datë 22.7.1998

Barrëmarrës
është barrëmarrësi sipas përkufizimit në nenin 1 të ligjit “Për barrët sigurorese” dhe kur është e përshtatshme i referohet gjithashtu edhe një agjencie shtetërore.

Barrëdhënës
është barrëdhënësi sipas përkufizimit në nenin 1 të ligjit “Për barrët sigurorese” dhe kur është e përshtatshme i referohet gjithashtu edhe një debitori sipas një pretendimi shtetëror.

Barrë sigurorese
është barra sigurorese sipas përkufizimit të nenit 1 të ligjit “Për barrët sigurorese”.

Ciklomotor
është mjeti sipas përkufizimit të nenit 52 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë nr.8378, datë 22.7.1998.

Emri i personit
është emri i pasuar nga atësia dhe mbiemri në rastin e personit fizik;
është emri i rregjistruar sipas vendimit të gjykatës në rastin e personit juridik
Kryeregjistruesi
është Kryeregjistruesi sipas përkufizimit në nenin 1 të ligjit “Për barrët sigurorese”.

Makinë bujqësore
është mjeti sipas përkufizimit të nenit 57 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë nr.8378, datë 22.7.1998.

Makinë teknologjike
është mjeti sipas përkufizimit të nenit 58 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë nr.8378, datë 22.7.1998

Mallra me numër serie
janë mallrat që renditen si vijon: automjete, ciklomotorë, makina bujqësore, makina teknologjike, mjete fluturimi, mjete lundrimi, motomjete, motorë mjeti fluturimi, rimorkio, trolejbuse.

Mjet fluturimi
është çdo lloj makinerie që siguron mbështetje në atmosferë nga reagimet e ajrit. Këtu përfshihet trupi i makinerisë, por nuk përfshihet motori i makinerisë.

Mjet lundrimi
është një mjet i ndërtuar për të transportuar persona ose sende, nëpërmjet ujit dhe që vihet në lëvizje kryesisht nga çdo lloj tjetër force, përveç forcës së muskujve dhe që i kalon gjashtë metra gjatësi.

Motomjet
është mjeti sipas përkufizimit të nenit 53 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë nr.8378, datë 22.7.1998.

Motor mjeti fluturimi

është motori i një mjeti fluturimi.

Numri i identifikimit

është numri i identifikimit që Kryeregjistruesi i jep barrëmarrësit ose personit regjistruar.

Numri i serisë

është numri i identifikimit, i shënuar përgjithmonë apo i ngjitur në mallrat me numër serie nga prodhuesi. Ky numër pëfshin vetën karaktere alfa-numerike, por jo shenja pikësimi, vija ndarëse apo shenja të tjera. Kur malli është mjet fluturimi, numri i serisë është numri që vendoset nga prodhuesi mbi veshjen e jashtme të tij. Kur malli është motor i një mjeti fluturimi, numri i serisë është numri që vendoset nga prodhuesi mbi motor.

Regjistri

është Regjistri i Barrëve Siguruese siç përkufizohet në nenin 1 të ligjit “Për barrët siguruese”.

Rimorkio

është mjeti sipas përkufizimit të nenit 56 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë nr.8378, datë 22.7.1998.

Trolejbus

është mjeti sipas përkufizimit të nenit 55 të Kodit të Rrugor të Republikës së Shqipërisë nr.8378, datë 22.7.1998.

Neni 2

Regjistrimi

Formularët e Regjistrimit të Barrëve Siguruese janë si më poshtë:

Njoftimi A – Regjistrimi i Barrës Siguruese. Ky njoftim ka shtojca.

Njoftimi B – Ndryshimi i Regjistrimit. Ky njoftim ka shtojca.

Njoftimi C – Regjistrimi i Pretendimeve Shtetërore.

Njoftimi D – Kërkesa për Informacion

Njoftimet dhe shtojcat duhet të plotësohen sipas Udhëzuesit të Kryeregjistruesit siç parashikohet në nenin 3 të kësaj Rregulloreje.

Personi regjistruar është përgjegjës për të siguruar se njoftimi është plotësuar saktësisht e plotësisht dhe në përputhje me ligjin “Për barrët siguruese”, me Rregulloren e Barrëve Siguruese dhe me Udhëzuesin e Kryeregjistruesit.

Neni 3

Udhëzuesi i Kryeregjistruesit

Kryeregjistruesi mund të japë udhëzimet e tij për plotësimin e njoftimeve dhe herë pas here mund të ndryshojë, plotësojë dhe shfuqizojë udhëzimet kur është e përshtatshme.

Neni 4

Kohëzgjatja e regjistrimit

Regjistrimi i barrës siguruese është i vlefshëm për afatin prej 1 deri në 25 vjet ose pafundësisht siç shënohet në njoftimin e regjistrimit, me përjashtim të rasteve kur barra fshihet përpara mbarimit të këtij afati.

Regjistrimi i një pretendimi shtetëror është i vlefshëm deri në çastin që fshihet.

Regjistrimi bëhet i vlefshëm nga çasti i futjes së të dhënave në sistemin e Regjistrimit dhe është i gjatshëm siç parashikohet në nenin 28 pika “dh” të ligjit “Për barrët siguruese”.

Riregjistrimi i një regjistrimi është i pavlefshëm nëse përpara momentit të riregjistrimit kanë ndodhur dy ngjarjet e mëposhtme:

a) të paktën njëra nga kërkesat e përmendura në nenin 8 pika a-ç të ligjit “Për barrët siguruese”, që ka lidhje me një barrë siguruese konkurruese, është përmbushur pas fshirjes apo përfundimit të regjistrimit; dhe

b) të paktën njëra nga kërkesat e përmendura në nenin 8 pikat a-ç të ligjit “Për barrët siguruese” që ka lidhje me një barrë siguruese konkurruese është përmbushur para fshirjes apo përfundimit të regjistrimit.

Kryeregjistruesi do të drejtojë veprimtarinë e Regjistrit në mënyrë të tillë që të sigurojë që secili regjistrim dhe ndryshim regjistrimi të ketë një numër regjistrimi unik.

Neni 5 **Ndryshimet**

Njoftimi B do të përdoret për të ndryshuar një regjistrim.

Ndryshimet janë si vijon:

- a) zgjatje e një regjistrimi,
- b) fshirje e një regjistrimi,
- c) reregjistrimi i një regjistrimi që ka përfunduar apo është fshirë,
- ç) nënrenditje e një regjistrimi,
- d) shtim i një barrëmarrësi,
- dh) fshirje e një barrëmarrësi,
- e) ndryshim i informacionit /transferimi i të drejtës së barrëmarrësit,
- ë) shtim i një barrëdhënësi,
- f) fshirje e një barrëdhënësi,
- g) ndryshim i informacionit/transferim i të drejtës së barrëdhënësit,
- gj) shtim kolaterali,
- h) fshirja kolaterali,
- i) ndryshim i informacionit mbi kolateralin/zëvendësimi i kolateralit,
- j) ndryshime të tjera/vendim gjykate,
- k) korrigjim i Regjistrit.

Neni 6 **Nënshkrimi**

Njoftimi duhet të nënshkruhet nga barrëmarrësi ose nga një person tjetër i autorizuar për ta bërë këtë në emër të tij.

Një simbol elektronik që është i aprovuar nga Kryeregjistruesi ose numri i identifikimit që caktohet nga Kryeregjistruesi është i mjaftueshëm.

Deri sa Kryeregjistruesi të bindet se të gjithë barrëmarrësit e shënuar në regjistrimin që do të ndryshohet kanë dhënë autorizimet e tyre, Kryeregjistruesi nuk do të bëjë ndryshimet e mëposhtme ndaj atij regjistrimi:

- a. fshirje regjistrimi,
- b) fshirje barrëdhënësi,
- c) ndryshim informacioni/transferim i të drejtës së barrëdhënësit,
- ç) fshirje kolaterali,
- d) ndryshim i informacionit mbi kolateralin/zëvendësim i kolateralit.

Deri sa Kryeregjistruesi të bindet se barrëmarrësi i shënuar në regjistrimin që do të ndryshohet ka dhënë autorizimin e tij, Kryeregjistruesi nuk do të bëjë ndryshimet e mëposhtme ndaj atij regjistrimi:

- a) fshirjen e këtij barrëmarrësi nga ky regjistrim; ose
- b) ndryshimin e informacionit ose transferimin e të drejtës së këtij barrëmarrësi.

Kryeregjistruesi mund të regjistrojë një njoftim pa pasur nevojë për provë që nënshkrimi në këtë njoftim është i barrëmarrësit apo i një personi të autorizuar nga barrëmarrësi.

Neni 7 **Emri i barrëdhënësit dhe i barrëmarrësit**

Në qoftë se barrëdhënësi ose barrëmarrësi është person fizik, në njoftim duhet të vendoset emri i personit.

Në qoftë se barrëdhënësi ose barrëmarrësi është person juridik, në njoftim duhet të vendoset emri i personit.

Në qoftë se barrëdhënësi ose barrëmarrësi është person fizik që kryen veprimtri tregtare me

një emër i cili nuk është emri i tij dhe kjo veprimtari tregtare nuk përbën person juridik, atëherë në njoftim duhet të shkruhet emri i personit fizik.

Në qoftë se barrëdhënësi ose barrëmarrësi është ortakëri që ka një emër të regjistruar, në njoftim duhet të vendoset emri i ortakërisë. Në qoftë se ortakëria nuk ka një emër të regjistruar, atëherë në njoftim duhet të vendosen emrat e ortakëve.

Në qoftë se barrëdhënësi ose barrëmarrësi është ndonjë lloj tjetër personi që nuk është përmendur në paragrafet e mësipërme të këtij neni, në njoftim duhet të vendoset emri që barrëdhënësi ose barrëmarrësi ka përdorur në marrëveshjen siguroese. Në qoftë se në çastin e regjistrimit nuk ekziston marrëveshje siguroese, në njoftim duhet të vendoset emri i përdorur zakonisht nga barrëmarrësi ose barrëdhënësi gjatë veprimtarisë tregtare.

Neni 8

Përshkrimi i kolateralit

Kur regjistrohen mallra me numër serie që nuk janë inventarë, përshkrimi duhet të përfshijë:

- a) llojin e mallrave siç parashikohet në Tabelën III të Udhëzuesit të Kryeregjistruesit;
- b) 25 karakteret e fundit të numrit të serisë së mallrave me numër serie;
- c) emrin e prodhuesit siç është shënuar mbi mallrat; dhe
- ç) vitin e prodhimit të mallrave.

Kur një regjistrim ose një ndryshim regjistrimi bëhet për:

- a) kolateral që nuk është mall me numër serie; ose
- b) mallra me numër serie që janë inventare

kolaterali mund të përshkruhet, kur është rasti, si “inventare”, “llogari”, “instrumente”, “para” dhe, në rastin e mallrave të tjera, përshkrimi bëhet në mënyrë të përgjithshme ose të veçantë.

Përshkrimi i mallrave si “mallra konsumi” ose si “pajisje” nuk mund të përdoret, përveç kur përshkrimi specifikon gjithashtu llojin e mallrave të konsumit apo pajisjeve. Për shembull, përshkrimi mund të jetë “pajisje bujqësore” ose “mallra konsumi, televizor”.

Përshkrimi i mallrave si “inventare” nuk është i vlefshëm kur mallrat nuk janë më inventare.

Të ardhurat koleteral duhet të përshkruhen në të njëjtën mënyrë si kolaterali fillestar i të njëjtit lloj.

Me përjashtim të mallrave me numër serie që klasifikohen si pajisje ose mallra konsumi, përshkrimi i kolateralit mund të jetë si vijon:

- a) mbi të gjithë pasurinë që barrëdhënësi ka në çastin e lidhjes së marrëveshjes siguroese si dhe mbi të gjithë pasurinë e fituar pas lidhjes së marrëveshjes siguroese; ose
- b) mbi të gjithë pasurinë ekzistuese të barrëdhënësit dhe mbi atë të fituar pas lidhjes së marrëveshjes siguroese, duke përjashtuar zëra të veçantë apo lloje të pasurisë; ose
- c) mbi të gjithë pasurinë ekzistuese të barrëdhënësit dhe mbi atë të fituar pas lidhjes së marrëveshjes siguroese, e cila është e një lloji të veçantë.

Neni 9

Vërtetimi

Kur regjistrohet një barrë siguroese ose pretendim shtetëror ose kur ndryshohet një regjistrim Kryeregjistruesi do t'i dërgojë barrëdhënësit, barrëmarrësit dhe personit regjistruar një vërtetim të regjistrimit me postë të zakonshme ose ndonjë mënyrë tjetër të vendosur nga Kryeregjistruesi.

Neni 10

Kërkimi i informacionit

Një person mund të kërkojë informacion nga Regjistri mbi bazën e një prej kritereve që vijnë:

- a) emri i barrëdhënësit;
- b) numri i serisë së mallrave me numër serie; ose
- c) numri i regjistrimit.

Informacioni që Regjistri jep në përgjigje të kësaj kërkesë duhet të përfshijë të dhënat aktive të rajtura në Regjistër, që i korrespondojnë emrit të barrëdhënësit, numrit të serisë së mallrave me numër serie dhe numri të regjistrimit. Rezultati i kërimit duhet të përmbajë, gjithashtu, datën, orën e regjistrimit dhe numrin që i është caktuar regjistrimit.

Kryeregjistruesi i dërgon personit që ka bërë kërkesën për informacion rezultatin e kërimit me postë ose sipas ndonjë mënyre tjetër të përcaktuar në Udhëzuesin e Kryeregjistruesit.

Neni 11

Gabimet e Regjistrimit

Kryeregjistruesi, me iniciativën e tij personale ose me kërkesën e barrëmarrësit, mund të korrigjojë gabimet e bëra nga Regjistri gjatë regjistrimit të të dhënave për barrën siguruese.

Korrigjimet e bëra nga vetë Kryeregjistruesi janë të vlefshme duke filluar nga çasti i bërjes së ndryshimeve dhe nuk kanë efekt prapaveprues.

Neni 12

Dorëzimi i njoftimeve dhe çështje të tjera

Njoftimet mund të dorëzohen në Regjistër personalisht, me postë ose sipas ndonjë mënyre tjetër të përcaktuar në Udhëzuesin e Kryeregjistruesit.

Regjistrimi apo kërkitimi i informacionit nuk mund të bëhet në qoftë se nuk është bërë pagesa përkatëse siç parashikohet në Udhëzuesin e Kryeregjistruesit.

Kryeregjistruesi mund të bëjë marrëveshje me çdo person për mënyrën e pagesës së tarifave për shërbimet e Regjistrimit. Kjo marrëveshje mund të parashikojë depozitimin e një shume që mbahet nga Regjistri nga e cila debitohen tarifat për shërbimet e Regjistrimit.

Tarifat që jepen në Udhëzuesin e Kryeregjistruesit duhet të paguhen për shërbimet e Regjistrimit.

Orari i punës së Regjistrimit do të jetë nga ora 9.00 deri në orën 17.00 nga e hëna deri të premten duke përjashtuar ditët e festave zyrtare.

Neni 13

Mirëmbajtja e Dokumenteve të Regjistrimit

Kryeregjistruesi duhet t'i mbajë njoftimet e regjistrimit, kopjet e rezultateve të kërimit dhe kopjet e çertifikatave të Kryeregjistruesit, në formë dokumenti, kompjuterike ose në ndonjë formë tjetër për jo më pak se dhjetë vjet pas datës së përfundimit të regjistrimit, të cilit i referohet ky dokument.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Rregullorja e Barrëve Siguruese hyn në fuqi ditën e parë të fillimit të veprimtarisë së Regjistrimit të Barrëve Siguruese, më datë 1 shkurt 2001.

MINISTRI I FINANCAVE
Anastas Angjeli